REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS
MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE
MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE
Njësia org. / Org. jedinica / Org. Unit: M-01 — Nr. i Prot. / Broj Prot. / Prot. No.: 5167/23
Nr. i Faqeve / Br. Stranica / No. Pages: 01 — Data / Datum / Date: 08.09.23
PRISHTINË / A — No. 1

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government

*Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës*
*Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture*
*Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure*

Nr. 255
Data: 31/08/2023

Ministri i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, duke u bazuar në nenin 93 paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenin 10 të Ligjit Nr.06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratën Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura (Gazeta Zyrtare, Nr.7, 01 Mars 2019), nenin 11 paragrafi 1, nën paragrafi 1.5 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare, Nr.34/22 dt. 18.11.2022), Shtojcës 1 pika 10 të Rregullores (QRK) Nr.14/2023 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, si dhe nenit 26 të Ligjit Nr. 03/L-233 për Mbrojtjen e Natyrës (Gazeta Zyrtare Nr. 85/2010), nxjerrë:

## V E N D I M
## PËR SHPALLJEN NËN MBROJTJE TË LLOJIT VENDOR TË ZBUTUR - "GJELI PIKLAN"

1. Lloji vendor i zbutur "Gjeli Piklan" shpallet nën mbrojtje lloj vendor i zbutur.

2. Qëllimi i mbrojtjes, rregullat e mbarështimit, ruajtja e bazës gjenetike dhe parametrave fenotiporë, mënyra e ruajtjes dhe e shfrytëzimit të llojit të mbrojtur "Gjeli Piklan" bëhet sipas Ligjit Nr. 03/L-233 për Mbrojtjen e Natyrës.

3. Të drejtën për mbajtjen dhe përkujdesjen e llojit "Gjeli Piklan" e ka secili person i cili i plotëson kushtet për mbarështim, mbrojtjen e shëndetit dhe mirëqenien e këtij lloji në pajtim me këtë Vendim dhe Ligjin Nr. 03/L-233 për Mbrojtjen e Natyrës.

4. Lloji "Gjeli Piklan" regjistrohet në Regjistrin për vlerat e Mbrojtura të Natyrës të cilin e mbanë Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës si dhe Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës.

5. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Liburn ALIU

Ministër i Ministrisë së Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës

Vendimi i dërgohet:

- Kabinetit të Ministrit;
- Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm;
- DMMU;
- AMMK/IKMN-së;
- MBPZHR
- Asociacionit Kombëtar për Kultivimin e Kafshëve të Imta
- Shoqatës për Kultivimin e Shpezëve "Gjeli i Egër i Kosovës" Pejë dhe
- Arkivit të MMPHI-së.